KIRNF 23
Pasiguria mbi Trajtimet e Tatimit mbi të Ardhurat

Referencat

- SNK 8 *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*
- SNK 10 *Ngjarjet pas periudhës raportuese*
- SNK 12 *Tatimet mbi të Ardhurat*

Historiku

1 SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat* përcakton kërkesat për aktivet dhe detyrimet tatimore aktuale dhe të shtyra. Një njësi ekonomike zbaton kërkesat në SNK 12 në bazë të ligjeve tatimore në fuqi.

2 Mund të jetë e paqartë se si ligji tatimor zbatohet për një transaksion ose për një rrethanë të caktuar. Mund të jetë e paqartë nëse një trajtim i veçantë tatimor sipas ligjit tatimor është i pranueshëm ose jo, deri sa autoriteti përkatës tatimor ose gjykata të marrin një vendim në të ardhmen. Rrjedhimisht, një kundërshti ose shqyrtim i një trajtimi të veçantë tatimor nga autoriteti tatimor mund të ndikojë në krijimin e një aktivi ose detyrimi tatimor aktual ose të shtyrë për njësinë ekonomike.

3 Në këtë interpretim:

(a) 'trajtimet tatimore' do t'i referohen trajtimeve të përdorura ose që planifikohen të përdoren nga një njësi ekonomike në deklarimet e tatimit mbi të ardhurat.

(b) 'autoritet tatimor' do t'i referohet organit ose organeve të cilat vendosin nëse trajtimet tatimore janë të pranueshme sipas ligjit tatimor. Kjo mund të përfshijë një gjykatë.

(c) një 'trajtim i pasigurt tatimor' është një trajtim tatimor për të cilin ekzistojnë paqartësi nëse autoriteti përkatës tatimor do ta pranojë trajtimin tatimor sipas ligjit tatimor apo jo. Për shembull, vendimi i një njësie ekonomike për të mos dorëzuar deklaratën tatimore të tatimit mbi të ardhurat në një juridiksion tatimor të caktuar ose për të mos përfshirë të ardhura të veçanta në fitimin e tatueshëm, është një trajtim i pasigurt tatimor nëse pranimi i këtij vendimi është i pasigurt sipas ligjit tatimor.

Objekti

4 Ky Interpretim sqaron mënyrën se si të zbatohen kërkesat e njohjes dhe të matjes sipas SNK 12 kur ka paqartësi mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat. Në një rrethanë të tillë, njësia ekonomike do të njohë dhe të masë aktivin ose detyrimin tatimor aktual ose të shtyrë, duke zbatuar kërkesat e SNK 12 bazuar tek fitimi i tatueshëm (humbja tatimore), baza e tatueshme, humbja e mbartur tatimore, tepricat e parapaguara tatimore të papërdorura dhe tek tarifa tatimore e përcaktuar duke zbatuar këtë Interpretim.

Çështjet

5 Kur ka paqartësi mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat, ky Interpretim sqaron:

(a) nëse një njësi ekonomike i konsideron veçmas trajtimet e pasigurta tatimore;

(b) supozimet që një njësi ekonomike bën për qëndrimin e autoriteteve tatimore për këto trajtime tatimore;

(c) mënyrën si një njësi ekonomike përcakton fitimin e tatueshëm (humbje tatimore), bazën e tatueshme, humbjet e mbartura tatimore, tepricat e parapaguara tatimore të papërdorura; dhe

(d) mënyrën si një njësi ekonomike të marrë në konsideratë ndryshimet e fakteve dhe të rrethanave.

Konsensus

Nëse një njësi ekonomike i konsideron veçmas trajtimet e pasigurta tatimore

6 Një njësi ekonomike do të përcaktojë nëse duhet të shqyrtojë çdo trajtim tatimor të pasigurt veçmas ose së bashku me një ose më shumë trajtime tatimore të tjera të pasigurta, bazuar në faktin se cila metodë parashikon më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Në përcaktimin e qasjes që parashikon më mirë zgjidhjen e pasigurisë, një njësi ekonomike mund të marrë në konsideratë, për shembull, (a) mënyrën se si përgatiten deklarimet e tatimit mbi të ardhurat dhe si mbështeten trajtimet tatimore; ose (b) çfarë parashikon njësia ekonomike në lidhje me qëndrimin e autoritetit tatimor, dhe si të zgjidhë çështjet që mund të lindin nga ky qëndrim.

7 Nëse një njësi ekonomike, duke zbatuar paragrafin 6, merr në konsideratë më shumë se një trajtim tatimor të pasigurt së bashku, njësia ekonomike kur flet për një 'trajtim të pasigurt tatimor' sipas këtij Interpretimi, do t'i referohet grupit të trajtimeve të pasigurta tatimore të shqyrtuara së bashku.

Shqyrtimi nga autoritetet tatimore

8 Kur bëjmë një vlerësim nëse një trajtim i pasigurt tatimor ndikon, dhe sa është ky ndikim në përcaktimin e fitimit të tatueshëm (humbjes tatimore), bazës tatimore, humbjes së mbartur tatimore, të tepricave të parapaguara tatimore të papërdorura, një njësi ekonomike do të marrë si të mirëqenë se një autoritet tatimor do të shqyrtojë shifrat e deklaruara për të cilat ka të drejtë t'i kontrollojë dhe se autoriteti tatimor ka njohuri të plota për të gjitha informacionet që kanë lidhje me kryerjen e këtyre kontrolleve.

Përcaktimi i fitimit të tatueshëm (humbjes tatimore), bazës së tatueshme, humbjeve të mbartura tatimore, tepricave të parapaguara tatimore të papërdorura

9 Një njësi ekonomike do të marrë në konsideratë nëse është e mundur që një autoritet tatimor të pranojë një trajtim të pasigurt të tatimor.

10 Nëse një njësi ekonomike arrin në përfundimin se është e mundshme që autoriteti tatimor të pranojë një trajtim të pasigurt tatimor, njësia ekonomike do të përcaktojë fitimin e tatueshëm (humbjen tatimore), bazën tatimore, humbjen e mbartur tatimore, tepricat e parapaguara tatimore të papërdorura ose tarifat tatimore në përputhje me trajtimin tatimor të përdorur ose të planifikuar për t'u përdorur në deklaratën e tatimit mbi të ardhurat.

11 Nëse një njësi ekonomike arrin në përfundimin se nuk është e mundur që autoriteti tatimor të pranojë një trajtim të pasigurt tatimor, njësia ekonomike do të pasqyrojë efektin e pasigurisë në përcaktimin e fitimit të tatueshëm (humbjes tatimore), bazës së tatueshme, humbjeve të mbartura tatimore, tepricave të parapaguara tatimore të papërdorura ose tarifave tatimore. Një njësi ekonomike do të pasqyrojë efektin e pasigurisë për çdo trajtim tatimor të pasigurt duke përdorur njërën nga metodat e mëposhtme, në varësi të metodës që njësia ekonomike pret të parashikojë më mirë zgjidhjen e pasigurisë:

(a) metoda e vlerës më të mundshme - shuma e vetme më e mundshme sipas një serie rezultatesh të mundshme. Vlera më e mundshme mund të jetë zgjidhja më e mirë e pasigurisë nëse rezultatet e mundshme janë dy-polare ose të përqëndruara në një vlerë.

(b) metoda e vlerës së parashikuar - shuma e vlerave të ponderuara të mundshme sipas një serie rezultatesh të mundshme. Vlera e parashikuar mund të jetë zgjidhja më e mirë e pasigurisë nëse ekziston një larmishmëri e rezultateve të mundshme që nuk janë as dy-polare dhe as të përqëndruara në një vlerë.

12 Nëse një trajtim i pasigurt tatimor ndikon në tatimin aktual dhe në tatimin e shtyrë (për shembull, nëse ai ndikon si në fitimin e tatueshëm që përdoret për të përcaktuar tatimin aktual ashtu dhe në bazën tatimore të përdorur për të përcaktuar tatimin e shtyrë), një njësi ekonomike do të bëjë gjykime dhe vlerësime të qëndrueshme për tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë.

Ndryshime të fakteve dhe të rrethanave

13 Një njësi ekonomike do të rivlerësojë një gjykim ose vlerësim siç kërkohet nga ky Interpretim nëse faktet dhe rrethanat në të cilat është bazuar gjykimi ose vlerësimi ndryshojnë ose si rezultat i informacioneve të reja që kanë ndikim në gjykimin ose vlerësimin në fjalë. Për shembull, një ndryshim në fakte dhe rrethana

 © Fondacioni i SNRF-ve

mund të ndryshojë konkluzionet e një njësie ekonomike në lidhje me pranimin e një trajtimi tatimor ose vlerësimin e njësisë ekonomike për efektin e pasigurisë ose të dyja. Paragrafët A1-A3 përcaktojnë udhëzime për ndryshimet në fakte dhe rrethana.

14 Një njësi ekonomike do të pasqyrojë efektin e ndryshimit të fakteve dhe rrethanave ose të informacionit të ri si një ndryshim në vlerësimin kontabël duke zbatuar SNK 8 *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare.* Një njësi ekonomike duhet të zbatojë SNK 10 *Ngjarjet pas periudhës së raportimit* për të përcaktuar nëse një ndryshim që ndodh pas periudhës raportuese është një ngjarje që kërkon rregullim të pasqyrave financiare apo jo.

Shtojca A
Udhëzime të zbatimit

Kjo shtojcë është një pjesë përbërëse e KIRNF 23 dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të KIRNF 23.

Ndryshime të fakteve dhe të rrethanave (paragrafi 13)

A1 Në zbatimin e paragrafit 13 të këtij Interpretimi, një njësi ekonomike do të vlerësojë rëndësinë dhe efektin e ndryshimit të fakteve dhe rrethanave ose të informacionit të ri në kuadrin e ligjeve të aplikueshme tatimore. Për shembull, një ngjarje e veçantë mund të rezultojë në rivlerësimin e një gjykimi apo parashikimi të bërë për një trajtim tatimor të caktuar, dhe mund të mos rezultojë i tillë për një trajtim tatimor tjetër, nëse këto trajtime tatimore janë subjekt i ligjeve të ndryshme tatimore.

A2 Shembuj të ndryshimeve në fakte dhe rrethana ose informacione të reja të cilët, në varësi të rrethanave, mund të rezultojnë në rivlerësimin e një gjykimi ose të një vlerësimi të kërkuar nga ky Interpretim, përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në sa më poshtë:

(a) shqyrtimin ose ndërmarrjen e veprimeve nga ana e autoriteteve tatimore. Për shembull:

(i) pranimi ose mospranimi nga autoriteti tatimor i trajtimit tatimor ose i një trajtimi të ngjashëm tatimor të përdorur nga njësia ekonomike;

(ii) informacioni që autoriteti tatimor ka rënë dakord ose që nuk nuk ka pranuar një trajtim të ngjashëm tatimor të përdorur nga një njësi ekonomike tjetër; dhe

(iii) informacioni në lidhje me shumën e përfituar ose të paguar për zgjidhjen e një trajtim të ngjashëm tatimor.

(b) ndryshimet në rregullat e vendosura nga një autoritet tatimor.

(c) tejkalimi i afatit të së drejtës nga autoriteti tatimor për të shqyrtuar ose rishqyrtuar një trajtim tatimor.

A3 Mungesa e një pranimi ose mospranimi nga autoriteti tatimor i një trajtimi tatimor, si një rast i izoluar, nuk mund të përbëjë një ndryshim të fakteve dhe rrethanave apo informacione të reja që ndikojnë në gjykimet dhe vlerësimet e bëra sipas këtij Interpretimi.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

A4 Kur ka pasiguri në lidhje me trajtimet e tatimit mbi të ardhurat, një njësi ekonomike do të përcaktojë nëse duhet të japë informacione shpjeguese mbi:

(a) gjykimet e bëra në përcaktimin e fitimit të tatueshëm (humbjes tatimore), bazës së tatueshme, humbjeve të mbartura tatimore, tepricave të tatimeve të parapaguara dhe normave tatimore duke zbatuar paragrafin 27G të SNK8; dhe

(b) supozimet dhe vlerësimet e bëra në përcaktimin e fitimit të tatueshëm (humbjes tatimore), bazës së tatueshme, humbjeve të mbartura tatimore, tepricave të tatimeve të parapaguara dhe normave tatimore duke zbatuar paragrafët 31A–31E të SNK 8.

A5 Nëse një njësi ekonomike arrin në përfundimin se është e mundur që një autoritet tatimor do të pranojë një trajtim të pasigurt tatimor, njësia ekonomike duhet të përcaktojë nëse do të japë informacion për efektin e mundshëm të pasigurisë si një pasiguri e lidhur me tatimin bazuar në paragrafin 88 të SNK 12.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Shtojca B
Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Kjo shtojcë është një pjesë përbërëse e KIRNF 23 dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të KIRNF 23.

Data e hyrjes në fuqi

B1 Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë Interpretim për periudhat raportuese që fillojnë më 1 janar 2019 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Interpretim për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

B1A SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* i publikuar në prill 2024 ndryshoi paragrafët 14 dhe A4. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.

Periudha kalimtare

B2 Gjatë zbatimit fillestar, një njësi ekonomike do të zbatojë këtë Interpretim ose:

(a) duke zbatuar në mënyrë retrospektive SNK 8, nëse kjo është e mundur pa përdorimin e gjykimit retrospektiv; ose

(b) duke zbatuar në mënyrë retrospektive ketë Interpretim, duke njohur efektin e akumuluar të zbatimit fillestar të këtij Interpretimi në datën e zbatimit për herë të parë. Nëse një njësi ekonomike zgjedh këtë qasje kalimtare, asaj nuk i kërkohet të riparaqesë informacionin e periudhës krahasuese. Por njësia ekonomike do të njohë efektin e akumuluar të zbatimit fillestar të këtij Interpretimi si një rregullim në tepricën e fitimeve të pashpërndara (ose një përbërës tjetër më të përshtatshëm të kapitalit neto). Data e zbatimit fillestar është fillimi i periudhës të raportimit në të cilën njësia ekonomike zbaton për herë të parë këtë Interpretim.